


Tregtia e jashtme e mallrave

Dhjetor 2019

Tiranë, më 17, Janar 2019: Në Dhjetor 2019 eksportet e mallrave arritën vlerën 22 mld lekë, duke u rritur me 1,2 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe duke u ulur me 11,5 %, në krahasim me Nëntor 2019. Importet e mallrave arritën vlerën 55 mld lekë duke u ulur me 7,6 %, në krahasim me një vit më parë dhe duke u rritur me 4,8 %, në krahasim me Nëntor 2019. Deficiti tregtar i këtij muaji është 34 mld lekë duke u ulur me 12,6 %, krahasuar me Dhjetor 2018 dhe duke u rritur me 19,1 %, në krahasim me Nëntor 2019.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në vitin 2019 eksportet e mallrave arritën vlerën 299 mld lekë duke u ulur me 3,8 %, krahasuar me një vit më parë dhe importet e mallrave arritën vlerën 649 mld lekë duke u rritur me 1,2 %, krahasuar me një vit më parë. Deficiti tregtar arriti vlerën 350 mld lekë duke u rritur me 5,8 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2018.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Rritja vjetore e eksporteve prej 1,2 %, këtë muaj është ndikuar nga grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +7,2 pikë përqindje, “Ushqim, pije, duhan” me +1,3 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me +0,1 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve kanë ndikuar negativisht grupet: “Tekstile dhe këpucë” me -4,6 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -1,5 pikë përqindje dhe “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me -1,2 pikë përqindje.

Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Dhjetor 2019




Eksportet gjatë këtij viti janë ulur me 3,8 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të eksporteve janë: “Materiale ndërtimi dhe metale” me -2,5 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -2,0 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -1,8 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të eksporteve kanë ndikuar pozitivisht grupet: “Ushqim, pije, duhan” me +1,0 pikë përqindje, “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +0,9 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me +0,5 pikë përqindje.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Rënia vjetore e importeve prej 7,6 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -2,7 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -2,7 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -1,0 pikë përqindje, “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me -0,6 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve kanë ndikuar pozitivisht grupet: “Ushqim, pije, duhan” me +1,1 pikë përqindje.

Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Dhjetor 2019



Në vitin 2019 importet janë rritur me 1,2 %, krahasuar me vitin 2018. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve janë: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +1,4 pikë përqindje, “Ushqime, pije, duhan” me +0,6 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me +0,2 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve kanë ndikuar negativisht grupet: “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me -0,6 pikë përqindje, “Lëkurë dhe artikuj prej tyre” me -0,2 pikë përqindje dhe “Tekstile dhe këpucë” me -0,2 pikë përqindje.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Dhjetor 2019 vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve në krahasim me Dhjetor 2018 janë: Spanja (+115,7 %), Kosova (+3,0 %) dhe Greqia (+18,0 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (-9,8 %), Kina (16,5 %) dhe SHBA (55,2 %).

Gjatë këtij viti vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë janë: Kosova (+10,0 %), Gjermania (+5,6 %) dhe Maqedonia (+0,3 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (-4,0 %), Spanja (1,4 %) dhe Greqia (-2,5 %).

Në muajin Dhjetor 2019 vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve në krahasim me Dhjetor 2018 janë: Turqia (+23,3 %), Gjermania (+4,3 %) dhe Spanja (+46,7 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (-10,9 %), Kina (-6,0 %) dhe Greqia (-23,2 %).

Gjatë këtij viti vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë janë: Turqia (+14,0 %), Kina (+11,0 %) dhe Greqia (+4,3 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (-6,3 %), Gjermania (-6,2 %) dhe Rusia (-8,2 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Dhjetor 2019



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE zënë 62,8 % të gjithë tregtisë. Në Dhjetor 2019 eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 76,7 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 57,3 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (29,1 %), Turqia (9,2 %), Gjermania (7,4 %) dhe Kina (7,2 %).

Shkëmbimet tregtare për vitin 2019 me vendet e BE zënë 68,1 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar – Dhjetor 2019 eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 76,6 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 63,9 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (34,4 %), Greqia (7,5 %), Kina (7,4 %) dhe Turqia (7,2 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2018	01 - 18	24	24,5	45	27,5	-21	52,5
	02 - 18	24	18,8	46	4,4	-22	52,0
	03 - 18	27	14,6	55	2,5	-28	49,0
	04 - 18	27	11,3	53	5,2	-26	50,9
	05 - 18	30	24,3	57	2,1	-27	53,1
	06 - 18	27	18,1	54	-4,6	-28	49,2
	07 - 18	27	8,2	58	6,0	-31	46,0
	08 - 18	20	10,8	48	-2,3	-28	42,4
	09 - 18	26	8,9	51	-4,4	-25	51,4
	10 - 18	30	21,3	58	1,2	-28	51,7
	11 - 18	27	7,0	56	2,7	-29	48,4
	12 - 18	22	-1,6	60	-1,2	-38	36,0
	Janar - Dhjetor 18	310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019	01 - 19	22	-7,3	42	-6,2	-20	51,9
	02 - 19	23	-5,3	50	8,5	-27	45,4
	03 - 19	28	2,7	56	1,4	-28	49,6
	04 - 19	27	0,1	57	8,9	-30	46,7
	05 - 19	28	-8,0	59	4,0	-31	47,0
	06 - 19	26	-4,1	53	-1,4	-28	47,9
	07 - 19	28	3,7	60	2,7	-32	46,4
	08 - 19	20	-1,8	52	7,1	-32	38,8
	09 - 19	25	-4,9	52	2,3	-27	47,8
	10 - 19	27	-10,2	59	1,8	-32	45,6
	11 - 19	25	-9,1	53	-5,8	-28	46,7
	12 - 19	22	1,2	55	-7,6	-34	39,4
	Janar - Dhjetor 19	299	-3,8	649	1,2	-350	46,0

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë)

	Eksporte				Importe			
	Dhjetor 2018	Dhjetor 2019	Jan.- Dhj. 2018	Jan.- Dhj. 2019	Dhjetor 2018	Dhjetor 2019	Jan.- Dhj. 2018	Jan.- Dhj. 2019
Vendet e BE-së	16.356	16.787	236.919	228.738	34.296	31.817	390.779	379.192
Austri	232	107	1.947	1.790	569	530	6.686	6.830
Mbretëri e Bashkuar	64	60	1.145	738	623	544	5.938	5.639
Gjermani	905	1.003	13.437	14.190	4.526	4.721	49.561	46.476
Greqi	856	1.010	13.115	12.781	5.100	3.916	52.101	54.336
Itali	10.408	9.393	149.101	143.099	14.706	13.098	175.279	164.179
Spanjë	1.509	3.255	24.174	23.845	823	1.208	16.068	11.529
Kroaci	123	91	946	1.118	732	779	6.675	7.219
Të tjera të BE-së	2.261	1.869	33.053	31.177	7.218	7.022	78.471	82.985
Kinë	415	347	5.693	6.211	5.588	5.255	53.817	59.716
Kosovë	2.141	2.205	27.093	29.812	823	602	8.909	7.735
Maqedonia e Veriut	586	728	8.543	8.566	852	735	9.591	8.571
Rusi	30	0	92	75	932	1.129	12.652	11.617
SHBA	567	254	5.353	3.667	997	1.189	9.176	12.330
Turqi	127	140	2.153	2.055	5.650	6.964	54.191	61.797
Ukrainë	7	15	246	172	193	267	3.080	3.016
Zvicër	69	46	2.933	890	1.783	942	10.238	15.337
Të tjera	1.342	1.369	21.411	18.593	8.964	2.591	89.033	89.755
Gjithsej	21.641	21.891	310.436	298.778	60.079	55.492	641.466	649.066

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë)

Grup-mallrat	Eksporte				Importe			
	Dhjetor 2018	Dhjetor 2019	Jan.- Dhj. 2018	Jan.- Dhj. 2019	Dhjetor 2018	Dhjetor 2019	Jan.- Dhj. 2018	Jan.-Dhj.2019
Gjithsej	21.641	21.891	310.436	298.778	60.079	55.492	641.466	649.066
Ushqime, pije, duhan	2.595	2.876	32.334	35.374	9.577	10.263	106.508	110.363
Minerale, lëndë djegëse, en,el,	3.141	4.691	56.398	50.274	7.763	6.127	68.385	77.235
Produkte kimike dhe plastike	459	480	6.191	7.653	8.130	7.788	87.748	88.725
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	199	161	2.727	2.444	1.488	1.248	18.896	17.327
Prodhime druri dhe letre	728	738	9.627	9.592	2.056	1.891	25.156	25.817
Tekstile dhe këpucë	8.879	7.882	123.742	118.191	7.516	6.899	88.222	87.198
Materiale ndërtimi dhe metale	3.595	3.263	53.194	45.385	7.088	5.463	78.396	78.438
Makineri, pajisje dhe pj, këmb,	1.390	1.125	18.002	20.891	13.657	13.281	142.335	138.734
Të tjera	655	674	8.222	8.974	2.805	2.532	25.819	25.229

Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë)

	Itali		Kosovë		Spanjë		Gjermani	
	2018	2019	2018	2019	2018	2019	2018	2019
Gjithsej	149.101	143.099	27.093	29.812	24.174	23.845	13.437	14.190
Ushqim, pije duhan	8.136	8.651	2.889	3.739	1.297	1.249	1.444	1.672
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	4.554	4.967	6.741	6.768	19.043	19.844	1.899	839
Produkte kimike dhe plastike	1.642	2.021	1.304	2.144	58	50	43	70
Lëkurë dhe artikujt prej lëkure	2.005	2.071	9	5	245	212	11	13
Prodhime druri dhe letre	6.879	6.340	512	913	6	4	164	182
Tekstile dhe këpucë	95.368	91.903	123	115	3.315	2.273	6.897	7.539
Materiale ndërtimi dhe metale	17.019	13.451	13.318	13.613	160	198	993	1.591
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	9.725	9.935	825	751	32	8	1.393	1.492
Të tjera	3.772	3.761	1.372	1.763	18	6	594	792

Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë)

	Itali		Turqi		Kinë		Greqi	
	2018	2019	2018	2019	2018	2019	2018	2019
Gjithsej	175.279	164.179	54.191	61.797	53.817	59.716	52.101	54.336
Ushqim, pije duhan	17.687	19.540	5.496	5.528	642	803	15.004	15.764
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	11.221	7.630	777	7.192	8	8	8.720	11.097
Produkte kimike dhe plastike	19.078	18.686	8.169	8.096	5.253	5.562	7.793	7.750
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	14.724	13.734	306	270	778	766	56	30
Prodhime druri dhe letre	7.359	6.919	3.521	3.369	1.117	1.061	3.389	3.534
Tekstile dhe këpucë	42.566	40.679	17.032	18.126	10.886	11.796	3.662	3.689
Materiale ndërtimi dhe metale	20.901	18.972	8.530	10.361	7.168	9.021	8.682	8.229
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	35.775	32.436	7.804	6.756	22.477	24.794	2.989	2.711
Të tjera	5.969	5.581	2.556	2.098	5.488	5.906	1.806	1.530

Metodologjia

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F,O,B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C,I,F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Mbretëria e Bashkuar, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri